



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Spektori i Sportit

Mitrovicë, 22.01.2025

FTESË PUBLIKE PËR PROJEKTET SPORTIVE PËR OJQ TË VITIT 2025(Thirrja e parë)

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport/Spektori i Sportit duke u bazuar në RREGULLOREN MF - NR – 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE ¹ i fton organizatat e regjistruara si **OJQ** (sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës), e me bazë në **Mitrovicë**, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e sportit , që të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet-idetë me karakter:

- Subvencionimi i klubeve kolektive
- Subvencionimi i klubeve individuale
- Lojërat tradicionale sportive fshatare
- Garat Shkollore
- Turniret multietnike

2. OJQ-të, në përputhje me këtë ftesë publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për promovimin e sportit.

Vlera e planifikuar për projektet në fushë e sportit

a) Mbështetja financiare për projektet sportive është paraparë deri në

250,000.00 Euro

- a) Shuma minimale(Lot 1) e mbështetjes financiare për OJQ-të Klube Kolektive që mund të alokohet për çdo projekt është 3,000.00 Euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 50,000.00 Euro
 - b) Shuma minimale(Lot 2) e mbështetjes financiare për OJQ-të Klube Individuale që mund të alokohet për çdo projekt është 2,000.00 Euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 5,000.00 Euro
 - c) Shuma minimale(Lot 3) e mbështetjes financiare për OJQ-të shoqatave sportive që mund të alokohet për çdo projekt është 1,000.00 Euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 2,500.00 Euro
4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë dhe përfundon me datën 11.02.2025

5. Kriteret administrative për OJQ-të:

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret administrative të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;
- të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;
- të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
- të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete; dhe
- të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Vërtetimin që OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK).
- OJQ-ja duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ nuk është nën hetime për vepra penale.
- Veprimtarinë e organizates ta ushtrojnë në qytetin përkatës të thirrjes.
- Vërtetimin që janë të regjistruara në Federatat përkatëse.
- Konfirmimin bankar.

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret specifike, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

6. Kriteret përmbajtësore të vlerësimit:

Me rastin e vlerësimit të projekt-propozimeve, Komisioni do të vlerësojë me sa vijon:

- a posedon OJQ-ja, kapacitete profesionale për të kryer aktivitetet e planifikuara të projektit /programit (a kanë aftësitë e duhura dhe aftësitë për zbatimin e projektit, si dhe njohuri në lidhje me çështjet që trajtohen në këtë ftesë)
- a posedojnë kapacitete të menaxhimit të mjaftueshme OJQ-ja (duke përfshirë personelin, pajisjet për të udhëhequr me projektin)?
- a është i përcaktuar ekipi i projektit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit?
- sa relevant është projekt-propozimi për qëllimet dhe fushat të ftesës publike (a ndërlidhet projekti me aktivitetet e parapara me politikat e fushës, të cilat i mbulon ftesa publike?
- a janë objektivat e projektit/programit të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe realisht të arritshme?
- a janë aktivitetet e projektit / programit të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme?
- a janë kostot e projektit/programit reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit?
- a janë kostot e projektit në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projektit/programit?

OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti (1) projekt në kuadër të kësaj ftese publike. Periudha e zbatimit të projektit është më së largu 3-6 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e promovimit të kulturës. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në **formularët e paraparë**, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në web-faqen e Komunës së Mitrovicës:: https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/thirrja-per-subvencionim-kulture/Dokumentet_e_kompletuara_duhet_të_dërgohen_personalisht_ose_me_postë_në_adresën_e_mëposhtme:

Komuna e Mitrovicës-Kati i parë, zyra pritëse

Rruga “Bedri Gjinaj”, 40,000 Mitrovicë

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të ftesës është i detajuar në **Udhëzimet për aplikuesit(lu lutem konsultone Udhëzuesin për aplikim)**.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë ftesë publike, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të ftesës publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: nazmi.racaj@rks-gov.net

Dokumentet që duhet të plotësohen i gjeni të bashkangjitur :

[F9 Formulari i Aplikacionit për projekt](#)

[F10-Formulari i buxhetit për sport](#)

[F11 Forma e deklaratës për financimin e dyfishte](#)

[F12 Formulari i deklaratës së partneritetit](#)

[F13 Forma e deklaratës së projekteve të financuara](#)

[F14 Deklarate mbi aktivitetet e përshkruara për kontraktimet](#)

[Shpallje për anëtar të komisionit për Vlerësimin e Projekteve në fushën e Kulturës \(4\)](#)

[Udhëzimet për Aplikantët për Sport](#)

[Vendimi për shpalljen publike](#)